



Republika e Kosovës	Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit	Institutja Ombudsmane • Ombudsperson Institution
Nr/Pr./No.	<u>10812024</u>
Nr. fjalor str./Nr. pg.	<u>1011212024</u>
Data/Datum/Date:	<u>PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA</u>



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

# Raporti Vjetor 2023 për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës

Prishtinë, më 10 dhjetor 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara: Institucioni i Avokatit të Popullit, Kosovë

Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN



Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës

*Ky raport u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, përmes projektit "Lufta kundër diskriminimit dhe urrejtjes", që është pjesë e programit të përbashkët "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë". Përbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.*

## Parathënie nga Avokati i Popullit

Barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi zë vend qendoror në spektrin e të drejtave të njeriut të shoqërive demokratike, ku bënë pjesë edhe Republika e Kosovës. Siç është theksuar në vazhdimësi edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parimi i mos-diskriminimit është i një natyre themelore dhe qëndron në themel të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku me sundimin e ligjit dhe vlerat e paqes dhe tolerancës.

Rendi juridik i Republikës së Kosovës ofron garanci të fuqishme kushtetuese dhe ligjore për mbrojtje nga diskriminimi për të gjithë personat dhe segmentet e shoqërisë kosovare, pa asnjë dallim. Nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës, si dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, i vitit 2015, janë dy shtyllat kryesore të kornizës normative për mbrojtje nga diskriminimi në Republikën e Kosovës.

Duke qenë institucion me mandat kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga shkeljet e autoriteteve publike, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rol dhe përgjegjësi të veçantë dhe të pazëvendësueshëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së barazisë para ligjit dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Si pjesë e rëndësishme e këtij funksioni të Avokatit të Popullit është mbikëqyrja i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo përfshinë paraqitjen e raporteve të përgjithshme, së paku çdo vit, në Kuvendin e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Ligjit – krahas raporteve të veçanta që Avokati i Popullit harton për këtë qëllim.

Raporti për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2023 shënon herën e parë që Avokati i Popullit paraqet një raport të tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Si i tillë, ky Raport në vetvete është një hap përpëra në përbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtje nga diskriminimi. Ajo çfarë është më e rëndësishme; pavarësisht se ky Raport përfshinë vitin 2023, ai paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, duke theksuar në mënyrë të veçantë efikasitetin e mekanizmave institucionale për mbrojtje nga diskriminimi.

Siç vihet në dukje në këtë Raport, sfida kryesore në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi është mungesa e të dhënavëve institucionale për rastet e raportuara të diskriminimit. Kjo vjen si pasojë e defekteve sistemike, përkatësisht mungesës së procedurave standarde për evidentimin e rasteve të diskriminimit, në sistemin e drejtësisë, në institucionet ligj-zbatuese apo në institucionet tjera gjegjës.

Shpresojmë se ky Raport do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe akterët tjera, për të zhvilluar një perspektivë të qartë lidhur me përgjegjësitë e tyre në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Institucioni i Avokatit të Popullit do ofrojë mbështetje të gjithanshme në këtë drejtim.

Institucioni i Avokatit të Popullit do vazhdojë të përbushë përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore në mbrojtjen nga diskriminimi, përmes trajtimit profesional dhe efikas të ankesave për diskriminim, hetimeve *ex officio* të rasteve dhe situatave që ndërlidhen me diskriminim, si dhe hartimit të raporteve me rekomandime. Ne do angazhohemi në mënyrë të veçantë në rritjen e vetëdijes institucionale për domosdoshmërinë e evidentimit rasteve të diskriminimit.

Përveç këtyre aktivitetave, Avokati i Popullit është angazhuar aktivisht në procesin e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili pritet të përfundojë fazën e konsultimeve publike gjatë pjesës së dytë të vitit 2024.

Ne do vazhdojmë dhe do thellojmë angazhimin tonë me qëllim të avancimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, si vlera sublime të mishëruara në themelit e shtetit dhe shoqërisë tonë.

### **Përbledhje ekzekutive**

Në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës për mbrojtjen nga diskriminimi, Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës i është besuar me nenin 9 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që në mënyrë sistematike të mbikëqyrë zbatimin e këtij Ligji. Deri me tani, Institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur raporte të rregullta vjetore për aktivitetet e tij, si dhe ka hartuar raporte të posaçme, *ex-officio* dhe sipas ankesave individuale, duke adresuar situata dhe raste që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë përfshirë informacione të përgjithshme dhe të dhëna për rastet e diskriminimit, por ky institucion asnjëherë nuk ka paraqitur në Kuvend një raport të veçantë vjetor për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, siç parashihet në nenin 9 të këtij Ligji. Me mbështetjen e Këshillit të Evropës, në vitin 2023 Institucioni i Avokatit të Popullit u përkushtua që të nxjerrë raportin e parë vjetor për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Pas përgatitjes së matricës specifike të monitorimit, e cila do të zbatohet gradualisht, Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua institucioneve të ndryshme përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, për të marrë të dhënat sasiore dhe cilësore të nevojshme për të vazhduar me analizën socio-juridike që është në thelb të çdo aktiviteti monitorues. Pritshmëritë nuk ishin të larta, por, për fat të keq, përgjigjet e marra nga këto institucione dolën nën parashikimet.

Pavarësisht se nuk mund të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të bazuar në tregues dhe të dhëna, ky Raport ka rëndësi qenësore në identifikimin e zbrazëtirave aktuale dhe aspekteve kritike që duhet të adresohen për të mundësuar mbikëqyrje efektive të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si pjesë e një cikli pozitiv që do të avancojë zbatimin e këtij ligj.

Ky Raport vendos një bazament për aktivitetet e ardhshme të mbikëqyrjes, duke mundësuar identifikimin e pengesave praktike dhe kulturore që do të duhet të hiqen në mënyrë, që Institucioni i Avokatit të Popullit të jetë në gjendje të kryejë plotësisht përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse ndaj zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Për më tepër, Raporti do të shërbejë si orientim për organin legjislativ, me të dhëna që mund të ndihmojnë në rishikimin që po i bëhet aktualisht Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e nevojshme për zbatimin më efikas të këtij Ligji në praktikë.

Mbi të gjitha, ky Raport nënizon edhe një herë se zbatimi i duhur i një Ligji nënkuption edhe mbledhjen e informacionit dhe të dhënave përkatëse pa të cilat nuk mund të bëhet monitorimi i tij.

Ky Raport jep gjashtë rekomandimeve konkrete dhe praktike, të cilat synojnë adresimin e problemit të zbatimit të pjesshëm i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi – duke qenë se nëse nuk mblidhen të dhëna për rastet e diskriminimit nga institucionet gjegjëse, është e pamundur të konkludohet se Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi zbatohet në tërësi. Raporti, gjithashtu, paraqet një mundësi që Institucioni i Avokatit të Popullit të ritheksojë përkushtimin e tij për të siguruar që diskriminimi të mos gjejë vend në shoqërinë kosovare.

## Tabela e përmbajtjes

Parathënje nga Avokati i Popullit .....	2
Përbledhje ekzekutive .....	4
Tabela e përmbajtjes .....	6
Lista e shkurtesave .....	7
Raporti kryesor .....	8
<b>1. Korniza normative për mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Kosovës .....</b>	<b>8</b>
1.1 Aktet kryesore normative për garantimin e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi.....	8
1.2 Procedurat ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi .....	9
<b>2. Detyrimi për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....</b>	<b>10</b>
2.1 Mekanizmat institucionalë me rol të drejtpërdrejtë në monitorimin e zbatimit të LMD .....	10
2.2 Ndërveprimi ndërmjet zbatimit praktik dhe mbikëqyrjes sistematike të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.....	11
<b>3. Gjendja aktuale e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi .....</b>	<b>12</b>
3.1 Zhvillimi i matricës së monitorimit dhe zbatimi i saj .....	14
<b>4. Gjetjet .....</b>	<b>16</b>
4.1 Mungesa e vetëdijes institucionale për nevojën e monitorimit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi .....	17
4.2 Mos plotësimi i infrastrukturës institucionale.....	17
<b>5. Përfundime dhe rekomandime .....</b>	<b>17</b>
Shtojcë .....	19

## **Lista e shkurtesave**

KiE Këshilli i Evropës

BE Bashkimi Evropian

LMD Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi

ZQM Zyra për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrat

IAP Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës

## Raporti kryesor

### 1. Korniza normative për mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Kosovës

Korniza normative për mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Kosovës përbëhet nga dy komponentë kryesore: aktet normative që garantojnë barazinë para ligjit dhe ndalojnë diskriminimin; si dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë procedura që duhet ndjekur personat fizik dhe juridikë, për të kërkuar mbrojtje nga diskriminimi.

#### 1.1 Aktet kryesore normative për garantimin e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Rendi juridik i Republikës së Kosovës ofron mbrojtje të shumëfishtë nga diskriminimi dhe të drejtën për barazi para ligjit. Këto të drejta janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe në një sërë ligjesh organike. Kushtetuta i atribuon statusin e dyfishtë të drejtës për barazi para ligjit dhe mbrojtjes nga diskriminimi. *Së pari*, e drejta për barazi para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit sanksionohet si parim themelor kushtetues në nenet 3 dhe 7 të Kapitullit I të Kushtetutës [Dispozitat Themelore]. *Së dyti*, barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi është e garantuar si e drejtë kushtetuese individuale në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], përkatësisht nenin 24 të Kushtetutës. Për më tepër, si e drejtë individuale, e drejta për barazi para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi garantonohet nga disa prej instrumenteve kryesore ndërkombe të tij të drejtave të njeriut të cilat, në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, kanë zbatim të drejtpërdrejtë në rendin juridik të Republikës së Kosovës. Duke qenë ndër të drejtat më themelore individuale të garantuara me Kushtetutë, parimi i ndalimit të diskriminimit përfshihet dhe garantonohet edhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Barazinë Gjinore, si dhe me shumicën e ligjeve themelore, përfshirë Ligjin e Punës, Ligjin për Zyrtarët Publikë, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi** (më tej në këtë Raport referuar edhe si *LMD ose Ligji*), zë një vend qendror në kornizën ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Ky Ligj, së bashku me Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, ishin pjesë e të ashtuquajturës “Pako Ligjore për të Drejtat e Njeriut”, e cila hyri në fuqi në vitin 2015. Siç është theksuar në nenin 1 të tij, LMD përcakton një kornizë të përgjithshme normative për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe garanton të drejtën për barazi para ligjit për të gjithë personat. Në frymën e neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, LMD ndalon diskriminimin “në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, originës shoqërore ose kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, bindjes dhe besimit fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale apo personale, moshës, gjendjes familjar ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë”. LMD e shtrin mbrojtjen e tij në sektorin publik dhe privat (neni 2), si dhe jep një përkufizim gjithëpërfshirës të të gjitha formave të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, ngacmimin, nxitjen për të diskriminuar, viktinizimin, segregacionin; diskriminimin në bazë të asociimit, mosdhënen e

një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, diskriminimin në bazë të perceptimit, diskriminimin e shumëfishjtë. Ky Ligji përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësinë institucionale për zbatimin e tij, në nivel qendror dhe lokal, ku rol dhe prerogativa të veçanta i janë besuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

LMD aktualisht është duke kaluar në një proces rishikimi, i cili është në fazën fillestare. Qëllimi i këtij rishikimi legjislativ është përshtatja e këtij Ligji për t’iu përgjigjur sfidave, nevojave dhe transformimeve shoqërore, si dhe harmonizimi i mëtejmë i tij me standardet që evoluojnë vazhdimisht të Këshillit të Evropës (KiE) dhe *acquis* të Bashkimit Evropian (BE). Ky proces i shqyrtimit vjen pas Raportit për Vlerësimin *Ex-Post* të Zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përgatitur nga Zyra Ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit dhe me pjesëmarrjen e akterëve kyçë institucionalë në fushën e mbrojtës nga diskriminimit, duke përfshirë Avokatin e Popullin.

## 1.2 Procedurat ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi

Në dritën e kornizës normative të cekur më sipër, të gjithë personat në Republikën e Kosovës kanë në disponim procedura dhe mjete të ndryshme juridike, që mund t’i përdorin nëse pretendojnë se janë diskriminuar. Këto procedura mund të janë të natyrës administrative, kundërvajtëse ose gjyqësore.

Sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, krahas ligjeve dhe akteve nënligjore specifike, çdo person që pretendon se është diskriminuar mund të iniciojë procedurë administrative. Kjo fillon me paraqitjen e një ankesë pranë institucionit ose organit që ka kryer shkeljen (në institacione e pushtetit qendror dhe lokal; institacione të zbatimit të ligjit dhe të tjera). Ata gjithashtu mund të iniciojnë procedura në organe të pavarura si Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ose me mekanizma të veçantë institucional, si Zyra e Komisionerit të Gjuhëve apo Inspektorati i Punës.

LMD parashev se rastet e diskriminimit mund të trajtohen edhe me ndërmjetësim apo pajtim, siç parashihet me legjislacionin aktual (neni 21). Ai gjithashtu përcakton bazat për fillimin e procedurave për kundërvajtje, duke përfshirë shqiptimin e gjobave ndaj individëve, personave juridikë dhe institucioneve publike që kryejnë, nxisin ose mbështesin aktivitete diskriminuese (neni 23) dhe autorizon Avokatin e Popullit që të kërkojë nga organet kompetente që të fillojnë procedurat kundërvajtëse për diskriminim (neni 9, parag. 2.4).

Në rastet e diskriminimit mund të iniciohen edhe procedura gjyqësore, të llojeve të ndryshme. Këtu përfshihen paditë për kompensimin e dëmit në procedurë civile, paditë për konflikt administrativ ndaj veprimeve ose mosveprimeve të organeve administrative që kanë elementë të diskriminimit, si dhe procedura penale përmes ngritjes së kallëzimit penal, nëse diskriminimi përbën veprën penale të “shkeljes së statusit të barabartë të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”.

Për më tepër, personat që pretendojnë se janë viktimi e diskriminimit mund të nisin procedurë tek Avokati i Popullit, duke paraqitur ankesa. Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit është ilustruar shkurtimisht në pjesën vijuese të këtij Raporti.

Pavarësisht nga ligjet e Kosovës që ofrojnë mbrojtje gjithëpërfshirëse nga diskriminimi, në praktikë vazhdon të ketë zbrazëtira dhe mangësi në zbatimin e këtyre masave mbrojtëse ligjore.

Dy shembuj tipikë ilustrojnë këto mangësi. *Së pari*, ekziston një mungesë e dukshme e zbatimit të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me procedurat kundërvajtëse për diskriminimin. *Së dyti*, në procedurat e rralla gjyqësore në lidhje me diskriminimin, gjykatat/gjyqtarët nuk zbatojnë me rigorozitet dispozitat e barrës së provës të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky ligj specifikon se barra e provës në procedurat gjyqësore që përfshijnë diskriminimin, bie mbi të paditurin. Moszbatimi më përpikmëri i parimit të barrës së provës në raste të tilla ishte evidente në disa procese gjyqësore për kompensimin e dëmeve për shkak të diskriminimit, të iniciuara nga personat me aftësi të kufizuara, në të cilat ishte i përfshirë Avokati i Popullit (p.sh., rasti C.nr.3663/18, F.K., kundër Komunës së Prishtinës).

## 2. Detyrimi për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Fillimisht, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet detyrimit ligjor për zbatimin e LMD dhe detyrimit ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Në aspektin e parë, barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi janë parime kushtetuese dhe të drejta individuale. Rrjedhimisht, çdo institucion publik ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të respektojë parimin e barazisë para ligjit dhe mos-diskriminimit – kjo do të thotë zbatimin i LMD. Për më tepër, nen 2 paragrafi 1 i LMD përcakton se dispozitat e tij zbatohen për të gjitha veprimet ose mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe personave fizikë e juridikë, të sektorit publik dhe privat. Gjithashtu, nen 8 specifikon se të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij ligji.

LMD, gjithashtu, vendosë mekanizma institucionalë dhe procedura specifike për monitorimin, gjegjësisht mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Megjithatë, përtej institucioneve që kanë rol të drejtpërdrejtë në mbikëqyrjen dhe raportimin për zbatimin e LMD, një vlerësim efektiv i zbatimit të këtij ligji kërkon bashkëpunim ndërinstitucional dhe veprime të përbashkëta.

### 2.1 Mekanizmat institucionalë me rol të drejtpërdrejtë në monitorimin e zbatimit të LMD

Struktura institucionale me rol të drejtpërdrejtë në mbrojtjen nga diskriminimi dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi përbëhet nga tri shtylla:

- a) Avokati i Popullit, si institucion i pavarur kushtetues;
- b) Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat (ZQM);
- c) Njësitë apo zyrtarët për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna.

#### a) *Institucioni i Avokatit të Popullit*

Neni 132 par. 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoritetet publike.

Roli dhe mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit tij janë të specifikuara në pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut që përfshin, përvëç LMD-së, Ligjin 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe Ligjin 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Nenet 9,12 dhe 18 të LMD përcaktojnë kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e këtij Ligji. Specifisht, neni 9, paragrafi 2.6, parasheh që Avokati i Popullit përcjell zbatimin e LMD dhe inicion ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi. Paragrafi 2.12 i të njëjtët nen i kërkon Avokatit të Popullit të paraqesë një raport të paktën çdo vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Ligji dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij. Për më tepër, nenet 16 dhe 18 përcaktojnë një sërë përgjegjësish të Avokatit të Popullit në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi, përkatësisht zbatimin e LMD (shih pjesën 2.3 përkitazi me aktivitetit kryesor të Avokatit të Popullit në luftimin e diskriminimit gjatë viti 2023). Departamenti për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Institucionit të Avokatit të Popullit luan rol qenësor në mbikëqyrjen dhe zbatimin e LMD. Ky Departament do të forcohet për të rritur më tej kapacitetet e tij në luftën kundër diskriminimit dhe garantimin e barazisë para ligjit.

*b) Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat*

Sipas LMD, ZQM në kuadër të Zyrës së Kryeministrat ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë në monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Neni 10 i LMD përcakton në mënyrë specifike përgjegjësinë dhe veprimet e ZQM, të cilat përfshijnë edhe paraqitjen e raporteve vjetore në Qeverinë e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji.

*c) Njësitë dhe zyrtarët për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna*

Neni 11 i LMD përcakton se të gjitha ministritë dhe komunat kanë detyrim të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të bashkërenduar dhe raportuar zbatimin e këtij Ligji. Kjo vë në spikamë rëndësinë që ka qeveria dhe komunat në monitorimin e zbatimit të LMD – veçanërisht në nivel lokal.

*d) Roli i institacioneve të tjera*

Ndonëse Avokati i Popullit, ZQM dhe njësitë/zyrtarët për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna janë të ngarkuara me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të mbikëqyrur zbatimin e LMD, këto institucione mund ta përmblushin këtë detyrë vetëm me bashkëpunimin e institacioneve të tjera relevante. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lidhje me mbledhjen dhe zërthimin e të dhënave përkatëse.

## **2.2 Ndërveprimi ndërmjet zbatimit praktik dhe mbikëqyrjes sistematike të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi**

Përderisa zbatimi i LMD është detyrim i përbashkët ndërmjet një morie mekanizmash institucional, përgjegjësia për mbikëqyrjen e zbatimit të tij, siç u përmend më lart, i është caktuar vetëm një numri të kufizuar organesh. Nuk ka se si të jetë ndryshe duke pasur parasysh se zbatimi i LMD ka për qëllim të garantojë jetësimin në praktikë të të drejtës kushtetuese të personave për mbrojtje nga diskriminimi në të gjitha fushat e ndryshme të jetës; ndërsa mbikëqyrja është një aktivitet institucional në funksion të garantimit të zbatimin të duhur të kornizës ligjore gjegjëse. Mbikëqyrja mëton të identifikojë, me ndihmën e treguesve specifik, nivelin e të kuptuarit të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga LMD dhe respektimin e tyre nga akterë të ndryshëm, me qëllim identifikimin e fushave ku nevojiten përmirësime. Duke qenë

se treguesit mund të jenë tregues strukturorë, tregues të procesit ose tregues të rezultatit, monitorimi, përkatesisht mbikëqyrja do rezultojë me rekomandime të ndryshme, për të adresuar mangësitë e identikuara në mbrojtjen nga diskriminimi.

Megjithëse dy procese të ndryshme, zbatimi në praktikë dhe mbikëqyrja e zbatimit të LMD janë të ndërthurura dhe me efekt të ndërsjellë. Kësosoj, zbatimi praktik i LMD mund të përfitojë nga rekomandimet e nxjerra si rezultat i mbikëqyrjes sistematike të tij. Mbikëqyrja e zbatimi të LMD, nga ana tjetër, nuk mund të kryhet pa të dhënat e ofruara nga organet përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji. Kjo sepse mbikëqyrja e zbatimit të një ligji është një proces sistematik i mbledhjes, analizimit dhe përdorimit të informacionit, i cili është vetëm pjesërisht i qasshëm për akterët e ndryshëm institucional. Së këndejmi, është e qartë se pa të dhëna dhe shënime të besueshme, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund t'i kryejë plotësisht obligimet e veta përkitazi me mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nuk mund të konceptohet e izoluar, ose që i përket vetëm një institucionin (në rastin konkret, IAP-së). Përkundrazi, ky proces është rezultati i një aktiviteti gjithëpërfshirës ku të gjitha hallkat institucionale që zbatojnë LMD-në kanë një rol për të luajtur, për të cilin, në fund, një institucion (IAP) merr përgjegjësinë përfundimtare. Ky rol nuk është thjesht pasiv (ku akterët institucionalë informohen për rezultatet e aktivitetit të mbikëqyrjes së zbatimit të LMD), por kërkon, minimalisht, sigurimin e të dhënavëve të besueshme, objektive dhe subjektive, që janë bazë e domosdoshme për zbatimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit.

Vetëm duke pasur të dhëna të plota dhe të besueshme, institucioni që ka për detyrë të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të LMD mund të vlerësojë ato, në krahasim me standarde përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe, në këtë mënyrë, të nxjerrë përfundime lidhur me zbatimin e LMD. Së këndejmi, në mungesë të të dhënavëve, çfarëdo angazhimi lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të LMD do ishte pa efekt dhe pa kuptim.

### 3. Gjendja aktuale e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Brenda arkitekturës institucionale të Kosovës, IAP ka një rol kyç në mbikëqyrjen sistematik të zbatimit të LMD. Deri me tani, IAP ka ofruar raporte të rregullta vjetore për aktivitetet e veta. Gjatë viteve, ky institucion ka hartuar gjithash tu reporte të posaçme, *ex-officio* dhe reporte të rasteve të iniciuara nga palët, duke përfshirë situata dhe raste që kanë të bëjnë me diskriminimin. Raportet vjetore që IAP i paraqet në Kuvend përfshijnë një seksion kushtuar barazisë para ligjit, ku përshkruhet puna e këtij institucionit si mekanizëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Përshkrimi i ofruar në raporte vjetore ku përfshihen baza të ndryshme të diskriminimit, është e bazuar në raste. Të dhënat dhe statistikat e ilustruara në këto raporte (nën titullin "Barazia para ligjit"), nuk janë të detajuara dhe të trajtuara gjëresisht. Një paraqitje e tillë e përgjithshme është e përshtatshme për një raport vjetor, por kjo asnjëherë nuk është konsideruar e mjaftueshme për të përmbrushur, në thelb, detyrimet që rrjedhin nga nen 9 paragrafi 2.6 i LMD.

Gjatë vitit 2023, IAP ka vazhduar hetimin e ankesave individuale për diskriminim dhe ka hapur raste *ex-officio*. IAP është marrë me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, diskriminimin e pensionistëve kontribut-pagues, rivlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, zbatimin e


masave të veçanta të përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore për përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e sektorit publik, si dhe çështja e kuotave gjinore në listat e kandidatëve sipas Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Nga ana tjetër, gjatë së njëjtës periudhë, IAP ka organizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve promovuese përmes punëtorive, konferencave dhe takimeve të drejtpërdrejta me qytetarë dhe palë të tjera të interesit, si dhe prezantimeve në media elektronike dhe të shkruara, ku u prezantuan të gjeturat e tij dhe rekomandimet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe barazinë para ligjit.

Në përputhje me mandatin e tij kushtetues, IAP ka shqyrtuar dhe ka bërë rekomandime për respektimin e parimit të mos-diskriminimit të një sërë aktesh normative, duke i referuar disa prej tyre për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Këto përfshijnë: Ligji nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (për të cilin Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se disa dispozita të këtij ligji janë në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit); neni 28 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; Ligji Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Në vitin 2023, Departamenti për Mbrojtjen nga Diskriminimi i IAP-së ka hapur për hetim 90 ankesa të pranuara nga qytetarët dhe dy raste *ex-officio*. Nga 90 ankesat e pranuara, 38 kanë të bëjnë me pretendime për diskriminim, të cilat së bashku me dy rastet e hapura *ex-officio* arrijnë në 40 raste të hetuara për diskriminim. IAP ka publikuar 6 raporte me rekomandime me të gjetura për diskriminim. Bazat e diskriminimit të pretenduara në ankesat e pranuara kanë të bëjnë me përkatësinë etnike, gjininë, moshën, aftësinë e kufizuar, mendimet politike, gjuhën, gjendjen shëndetësore, diskriminimin në vendin e punës, ushtrimin e profesionit dhe arsyen e tijer. Ndërsa rastet e hapura *ex-officio* kanë të bëjnë me Rregulloren nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, të nxjerrë nga Ministria e Financave e Kosovës; Përdorimi i Gjuhëve Zyrtare në Bankat Komerciale.

Nisur nga aktivitetet e IAP për vitin 2023, rezulton se shumica e ankesave dhe pretendimeve për diskriminim kishin të bënin me sferat si në vijim: marrëdhënia e punës, prona, qasja në drejtësi, qasja në sistemin e ndihmës sociale dhe shëndetësore. Në anën tjetër, disa nga kategoritë më të cenueshme janë personat me aftësi të kufizuara, gratë, personat LGBTQI+, komunitetet etnike (veçanërisht komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian).



Raportet vjetore të Avokatit të Popullit, pavarësisht gjithë-përfshirjes së tyre, nuk e mundësojnë vlerësimin e progresit në realizimin e të drejtës për mos-diskriminim – duke pasur parasysh se mungojnë të dhëna nga institucionet tjetra. Edhe kur përfshihen tregues objektivë dhe të matshëm lidhur me diskriminimin (siç janë numri i ankesave të marra dhe të zgjidhura), ato janë të kufizuara dhe jepen vetëm në lidhje me periudhën raportuese të IAP dhe jo përtej saj. Kjo e bënë të pamundur një vlerësim dinamik të trendëve të përgjithshme të zbatimit të LMD, si dhe shfaqjes në praktikë të të gjitha formave të diskriminimit. Siç u theksua më sipër, çdo raport gjithëpërfshirës për zbatimin e një ligji, ku LMD nuk bën përjashtim, kërkon mbledhje sistematike të të dhënavët nëpër institucionet tjetra dhe kjo ka munguar deri më tanë. Edhe kur jepen disa të dhëna sasiore përkitazi me diskriminimin, vrojtimet e raportit vjetor të Avokatit të Popullit nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të identifikuar zbrazëtirat ligjore dhe institucionale të cilat duhen adresuar, për të zvogëluar rastet e diskriminimit. Duhet pasur parasysh se në bazë të nenit 9, paragrafi 2.10, të LMD, Institucioni i Avokatit të Popullit ka për detyrim të mbledh të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera, si dhe të realizojë studime, hulumtime dhe trajnime, në lidhje me diskriminimin.

### 3.1 Zhvillimi i matricës së monitorimit dhe zbatimi i saj

Me qëllim të mbështetjes së Avokatit të Popullit për të realizuar përgjegjësitë e tij për mbikëqyrjen e zbatimit të LMD dhe për ta ndihmuar në hartimin e raportit të parë mbi LMD, në vitin 2023 Këshilli i Evropës krijoj një matricë monitorimi e cila u përfundua në bashkërendim me IAP. Matrica, e cila mund të gjendet si shtojcë e këtij Raporti, bazohet në dispozitat e LMD. Ajo është mjaft gjithëpërfshirëse dhe përmban jo vetëm tregues cilësorë, por edhe burimet e tyre; pra institucionet që duhet të jenë në gjendje ta përdorin atë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënavët për diskriminimin. Kjo vë në pah, edhe një herë, se procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të LMD kërkon bashkëpunim ndërinstitucional. Kësisoj, ky proces mund të jetë serioz në varësi të seriozitetit të të dhënavët që ai përban.

Përgjegjësia e përbashkët në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të LMD pasqyrohet në matricën që krahas treguesve rendit edhe burimin e informacionit. Meqenëse fillimisht matrica është duktur komplekse dhe tepër ambicioze, u ra dakord që IAP ta zbatojë atë gradualisht, duke përzgjedhur vetëm një numër të kufizuar akterësh dhe treguesish relativë (veçanërisht ata tregues që mund të ishin më lehtësish të disponueshëm dhe të qasshëm).

Me qëllim të përgatitjes së këtij Raporti (dhe brenda kuadrit të matricës së monitorimit), gjatë periudhës shkurt/maj 2024, IAP kërkoi informacion cilësor dhe sasior nga një numër të akterëve institucional, përkitazi me zbatimin praktik të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Janë këto institucionë të cilat kanë detyrim ligjor për t'u marrë me rastet e diskriminimit dhe që luajnë një rol qenësor në mbrojtjen nga diskriminimi në fusha të ndryshme. Në këtë vazhdë, IAP u drejtoi një kërkesë me shkrim institucioneve në vijim:

- Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Gjykatës Kushtetuese
- Policisë së Kosovës
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit
- Inspektoratit të Punës
- Zyra e Komisionerit për Gjuhët

Këtyre institucioneve iu drejtuan kërkesa për informacione me supozimin se, në përputhje me mandatin dhe kompetencat e tyre, evidentojnë dhe mbajnë të dhëna për rastet e raportuara të diskriminimit në fushat përkatëse. Konceptualisht, një aktivitet mbikëqyrjeje i një ligji si LMD duhet të përfshijë një analizë socio-ligjore që kombinon tregues të natyrave të ndryshme (analizë të literaturës dhe dokumenteve ligjore, si dhe të dhëna sasiore dhe cilësore). Megjithatë, në përgatitjen e këtij raporti u vendos që të fillojë kjo përpjekje e parë raportuese duke u përqendruar në të dhënat sasiore. Supozimi ishte se të dhënat e tillë për rastet të raportuara të diskriminimit do të regjistroheshin sistematikisht nga institucionet në fjalë. Në fakt, mbrojtja ligjore e të drejtave të njeriut lidhet me disponueshmërinë e statistikave zyrtare serioze për rastet e shkeljeve. Statistikat e tillë luajnë një rol qenësor në mbështetjen e politikebërjes së bazuar në të dhëna, si dhe në vlerësimin e përgjithshëm të të drejtave civile, politike, ekonomike dhe sociale.

Pavarësisht se janë kontaktuar në mënyrën e duhur të komunikimit zyrtar, disa nga institucionet e lartpërmendura nuk i janë përgjigjur fare kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit për të ofruar informacione; të tjera institucionë kanë dhënë informacion të përgjithësuar në lidhje me veprimtarinë e tyre. Shumë pak nga institucionet në fjalë u përgjigjën dhe asnjë nuk ishte në gjendje të ofronte të dhëna të plota lidhur me zbatimin e LMD, që mund të përdoren si bazë për aktivitetin e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij Ligji.

Përgjigjet e dërguara nga institucionet në fjalë, në Institucionin i Avokatit të Popullit ishin si më poshtë:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk i është përgjigjur kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit për marrjen e të dhënave për rastet gjyqësore që kanë të bëjnë me diskriminimin.<sup>1</sup>
2. Policia e Kosovës është përgjigjur se nuk ka të dhëna për ndonjë rast të raportuar të diskriminimit nga polici.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat i ofroi Institucionit të Avokatit të Popullit “Raportin për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në rastet e raportuara në platformën kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptianë”.
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ofruar një dokument të titulluar “Funksionimi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Komunë”. Dokumenti nuk përmban të dhëna për numrin e rasteve të diskriminimit në komuna, por informacion për strukturën dhe veprimtarinë e këtyre njësive.
5. Zyra e Komisionerit për Gjuhët nuk iu përgjigj kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me ankesat për diskriminim në përdorimin e gjuhëve.
6. Gjykata Kushtetuese iu përgjigj kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke informuar vetëm për aktgjykimet lidhur me tri ligje të veçanta, ku janë konstatuar shkelje të së drejtës për barazi para ligjit nga kjo Gjykatë. Nuk është dhënë asnjë informacion për ankesat kushtetuese individuale të paraqitura për diskriminim në Gjykatën Kushtetuese.

Përveç kërkesave drejtuar institucioneve gjegjëse, IAP ka analizuar faqet zyrtare të të gjitha institucioneve qendrore dhe komunave, me qëllim të vlerësimit të hapësirës që ato i jepin LMD-së dhe informacionit që i ofrojnë publikut në lidhje me mundësitë e ushtrimit të të drejtave të tyre sipas këtij ligji – duke përfshire edhe ofrimin e këshillave dhe mbështetjes për adresimin e pretendimeve dhe ankesave për diskriminim. Vetëm faqet e institucioneve gjyqësore ofrojnë disa informacione të përgjithshme dhe udhëzime për zbatimin praktik të LMD. Të gjitha faqet tjera institucionale të cilat janë analizuar nuk përbajnë asnjë informacion apo të dhënë, as për LMD dhe as për diskriminimin në përgjithësi.

Madje, edhe në rastet kur ne faqe të institucioneve të caktuara përbajnë informacione përviktimat e diskriminimit (siç është rasti me Platformën kombëtare kundër diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian”, të ZQM), ato nuk përbajnë udhëzime të nevojshme për mundësinë e inicimit të procedurave në IAP.

#### **4. Gjetjet**

Pavarësisht se nuk ka qenë e mundur të realizohej analizë gjithëpërfshirëse socio-ligjore, siç ishte planifikuar fillimisht, ky Raport ka rëndësi thelbësore sepse bënë identifikimin e mangësive dhe aspektave kritike që duhet të adresohen për të mundësuar mbikëqyrjen efektiv të zbatimit të LMD nga IAP-ja, si pjesë e përpjekjeve për zbatimin e këtij Ligji. Mbi këto gjetje janë dhënë rekomandime specifike, të cilat janë renditur në fund të këtij Raporti.

---

<sup>1</sup> Informacionet jozyrtare sugjerojnë se KGJK nuk ka të dhëna për rastet e diskriminimit.

#### **4.1 Mungesa e vetëdijes institucionale për nevojën e monitorimit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi**

Përgjigjet e institucioneve qendrore dhe lokale, siç u raportua më sipër, vënë në pah një mungesa të theksuar të vetëdijes institucionale për domosdoshmérinë e mbledhjes së të dhënavë dhe evidentimit të rasteve të diskriminimit. Duhet theksuar se mungesa e dëshmive institucionale lidhur me shkeljet e LMD nuk është tregues i gjendjes faktike të rasteve të diskriminimit. Është i njojur fakti se raportimet dhe ankesat për diskriminim, në sektorin publik dhe privat, janë të shpeshta; po ashtu edhe procedurat administrative dhe gjyqësore të nisur nga persona që pretendojnë se janë viktima të shkeljes së të drejtës për barazi para ligjit dhe mos-diskriminimit. Këto janë fakte të njoitura publikisht. Prandaj, ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet rasteve të pretenduara të diskriminimit dhe dëshmive zyrtare për to.

Gjatë viteve, IAP është angazhuar rregullisht në aktivitete të ndërgjegjësimit lidhur me LMD-në, që fokus kryesor kishte institucionet publike. Megjithatë, kjo nuk ka qenë e mjaftueshme. Siç është theksuar në Vlerësimin *Ex-Post* të Zbatimit të LMD, mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi, në nivel lokal dhe qendror, nuk kanë funksionuar në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna. Këtu përfshihet mosbatimi i dispozitave të kësaj Rregulloreje lidhur me raportin e njësive/zyrtarëve për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna, si dhe mbështetja e pamjaftueshme financiare dhe në forma të tjera për këta zyrtarë/njësi.

#### **4.2 Mos plotësimi i infrastrukturës institucionale**

Siç vërehet edhe në Raportin Vjetor 2023 të ZQM, një numër komunash ende nuk e kanë emëruar zyrtarin për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe mungan standardizimi i përshkrimit të punës së njësive dhe zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi, në nivelin e ministrisë dhe komunave. Duke pasur parasysh se LMD ka hyrë në fuqi gati një dekadë më parë, kjo mungesë e disa prej hallkave themelore të sistemit të përgjithshëm të parandalimit dhe mbrojtjes kundër diskriminimit është shqetësuese dhe ka ndikim në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Nisur nga faktet e lartpërmendura, rezulton se rastet e diskriminimit nuk regjistrohen sistematikisht. Këto raste nuk shënohen/identifikohen si të tilla as në procedurat gjyqësore dhe as administrative. Praktikisht, raste të tilla regjistrohen sipas registrave/shablloneve të përgjithshëm me të cilët regjistrohen rastet në procedurat gjyqësore apo administrativ, ku nuk ka shënimë dalluese që identifikojnë rastet e diskriminimit.

### **5. Përfundime dhe rekomandime**

Kur IAP, me mbështetjen e KE, u angazhua të përmbushë detyrimin e vet për të raportuar mbi mbikëqyrjen e zbatimit të LMD-së, ky institucion e kishte të qartë se raportimi i tij i parë do të ishte në mënyrë të pashmangshme i paplotë për shkak të të dhënavë të pamjaftueshme dhe shtrirjes së kufizuar të raportimit. Megjithatë, rezultati i përpjekjeve të bëra për hartimin e këtij Raporti është shumë nën pritshmëritë fillestar. Kjo si rezultat i faktit që, përvèç të dhënavë që disponon vet IAP dhe atyre të përfshira në raportin e ZQM-së, asnjë nga institucionet gjegjëse

të kontaktuara nuk ishin në gjendje të ofrojnë të dhëna sasiore dhe as cilësore, përkitazi me rastet e diskriminimit.

Pavarësisht sfidave dhe kufizimeve të cekura më sipër, ky Raport është i një rëndësie qenësore për arsyet në vijim:

- a) është gurthemel për raportet e ardhshme për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- b) identifikon pengesat që do të duhet të eliminohen në mënyrë që IAP të jetë në gjendje të zbatojë plotësisht përgjegjësitë e veta kundrejt LMD-së;
- c) vë në pah faktin se promovimi dhe mbrojtja nga diskriminimi nuk mund të konsiderohen si përgjegjësi të kufizuara në disa institucionë publike, por janë rezultat i një përpjekjeje të përbashkët dhe të koordinuar të të gjithë mekanizmave shtetërorë;
- d) ofron të dhëna, fakte dhe sugjerime të rëndësishme për procesin legjislativ të shqyrtimit të LMD-së, që është duke u zhvilluar aktualisht.

Në dritën e sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit bënë rekondimet e mëposhtme:

1. Të gjitha institucionet që kanë detyrim të zbatojnë Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi duhet të ofrojnë trajnim për personelin e tyre, lidhur me diskriminimin dhe përbajtjen e këtij Ligji, në aspektin formal dhe praktik;
2. Personeli i këtyre institucioneve duhet të jetë i vetëdijshëm për përgjegjësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Po ashtu, institucionet në fjalë duhet të jenë të gatshme dhe të përkushtuara për të bashkëpunuar me Institucionin e Avokatit të Popullit në procesin e mbikëqyries së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi;
3. Të gjitha institucionet që kanë detyrim të zbatojnë Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi duhet të krijojnë një sistem për mbledhjen sistematike të të dhënavëve në lidhje me diskriminimin;
4. Emërimet e zyrtarëve dhe/ose funksionalizimi i njësive për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna duhet të përfundohet brenda 12 muajve të ardhshëm;
5. Personalitë gjitha institucioneve relevante duhet t'i nënshistrohet trajnimit për të qenë në gjendje të mbledhë të dhëna për diskriminimin, për të mundësuar monitorimin e duhur të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi nga Instituti i Avokatit të Popullit;
6. Sistemi i klasifikimit të rasteve gjyqësore duhet të ndryshohet në mënyrë që të përfshijë të dhëna të ndara për diskriminimin në format e tij të ndryshme.



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Shtojcë	Lloji i treguesit	Metodat/Burimet e mbledhjes së të dhënave	Zbërthimi
Treguesit strukturon	Litteratura	Të dhëna administrative/zyrtare	Vëzhgimi
		Grupe të folkuar/komunitet	Bazë/grup i mbrojtar

S2. Titulli dhe data e hyrjes në fuqi në Kosovë të legjislacionit vendor (civil, penal, administrativ) lidhur me mos diskriminimin në periudhën raportuese (pas reportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	✓	Baza/grupe të mbrojtura
S3. Numri, hyrja në fuqi dhe mbulimi i mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi të paraqitura në periudhën raportuese (pas reportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	✓	Bazat/grupi i mbrojtur
S4. Titulli, lloji, data e miratimit dhe vlefshmëria e politikave kombëtare, strategjive dhe planeve të tjera të rëndësishme për mos diskriminimin (pas reportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	✓	Bazë/grupi i mbrojtur

S5. Titulli, fushëveprimi dhe data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore për parandalimin e diskriminimit në sektorin publik dhe privat) (pas raportit bazë do të veçohen vetëm ndryshimet në periudhën reportuese) (nëni 26 i LMD)	✓	✓	✓	Bazë/grup i mbrojtur
S6. Titulli, lloji, data e miratimit të akteve nënligjore/udhëzimeve/regullor eve që rregullojnë koordinimin, raportimin dhe bashkëpunimin me ZQM-në (nëni 11.2 LMD) (pas raportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën reportuese)	✓	✓	✓	Bazë/grup i mbrojtur
S7. Numri i memorandumeve të mirëkuptimit të nënshkruara me OJQ të përfshira në promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, duke përfshirë zonën e përgjegjësisë nëse jo në mbarë Kosovën (pas bazës do të veçohen vetëm varacionet në periudhën reportuese)	✓	✓	✓	Bazë/grup i mbrojtur, fokusi

S8. Titulli, fushëveprimi dhe data e hyrjes në fuqi të çdo kornizë rregullative vullnetare për të parandaluar diskriminimin (përfshire ato në lidhje me veprimet afirmative) në sektorin publik ose privat në periudhën raportuese (pas rapportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	✓	✓	Bazë/grup i mbrojtur
S9 Kodet e praktikave të mira për lufitim e diskriminimit dhe barazisë (neni 9.2.14 i LMD) (pas rapportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	✓	✓	
S10. Numri i ministrive (i matur kundrejt numrit të përgjithshëm të ministrive) që kanë emëruar një Njësi/Zyrtar për mosdiskriminim (neni 11.1) (pas rapportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	✓	✓	
S11. Stafi i NjDNj-së ministrore – duke përfshirë titullin funksional, detyrat, kohën që i kushtohet këtij roli (në rast të funksioneve të përziera) (pas rapportit bazë do të veçohen	✓	✓	✓	✓	✓	

vëtëm variaconet në periudhën raportuese)				
S12. Numri i NjDNj-ve të themeluarë në nivel komune (i matur kundrejt numrit total të komunave) (pas reportit bazë, do të veçohen vëtëm variaconet në periudhën raportuese) (neni 11.1 LMD)	✓	✓		
S13. Stafi i NjDNj-së komunale – duke përfshirë titullin funksional, detyrat, kohën që i kushtohet këtij roli (në rast të funksioneve të përziera) (neni 11.1 LMD) (pas reportit bazë do të veçohen vëtëm variaconet në periudhën raportuese)	✓	✓		
S14. Qasja e NjDNjK-së (përfshirë praninë e pamkartave, indikacioneve, faqeve të internetit, orarin e punës) dhe qasja fizike/gjuhësore (neni 11.1 LMD) (pas reportit bazë do të veçohen vëtëm variaconet në periudhën raportuese)	✓	✓	✓	Gjuha, aftësia e kufizuar (d.m.th. braille, gjyra e shenjave), mosha

S15. Disponueshmëria në ueb-faqen e institucioneve publike të informacionit për të drejtat e qytetarëve dhe mundësia për të paraqitur ankesa në IAP lidhur me diskriminimin (neni 25.2 LMD) (pas raportit bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën reportuese)	✓	✓	✓	✓	Gjuha, artësia e kufizuar (p.sh. lexueshmëria dhe dëgjueshmëria e përmirësuar.)	
Pjesa e buxhetit publik të dedikuar për zbatimin e LMD (pas raportit të parë bazë do të veçohen vetëm varacionet në periudhën reportuese)	✓	✓	✓	✓	Sipas institucionit, sipas aktivitetit	